



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Fushe-Arrez me, 28.02.2023

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS -“Blerje karburanti Diesel per autonjetet e Bashkise Fushe-Arrez ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
09134100-8 Karburant diesel

VLERA E FONDIT LIMIT - 7,460,000 (shtate million e katerqind e gjashtedhete mije) **leke pa TVSH.**

Argumentimi për llogaritjen e fondit limit : Çmimi ne burse eshte $810\$ \times 108.5$ leke(data 27.02.2023)=87,885 leke /ton

Vlera premio eshte $30\$ \times 108.5$ leke=3,255 leke /ton

1-Vlera ne burse + premio eshte $87,885$ leke/ton+ $3,255$ lek/ton= $91,140$ leke/ton ose 91,14 leke/liter.

2-Vlera e taksave:

- a- Aksiza 38 leke/liter
- b- Takse qarkullimi 27 leke/liter
- c- Takse karboni 3 leke/ liter
- d- Takse markimi 1 leke/liter

Vlera e taksave $(38+27+3+1)$ leke=69leke/liter

Shuma eshte 91.14 leke /liter + 69 leke/liter = $160,14$ leke/liter

Vlera e tvsh 20%=32,028 leke/liter

Totali është 192,168 leke /liter

Sasia e pritshme është 46584 litra

Në bazë të nenit 21, pika 2, neni 77, pika 2, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 pika 4, pika 5, pika 6 dhe pika 8 autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimin për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76, si dhe bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: “1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.” si dhe në nenin 30 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Duhet te paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI, qe subjekti ofertues ka importuar / tregtuar karburante sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise per vitin 2022.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.1.2 Çdo operator ekonomik duhet qe te sjelle bashkengjitur me oferten, flete analizat per karburantin e kerkuar (gazoil deri 10 ppm naftë) leshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik, dhe Industrial , Drejtoria e Laboratorit Qendror te Kontrollit (laboratori i kontrollit te naftes dhe gazit) .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si edhe referuar Ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 ”Për përpunimin, transportin dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet. Raport analiza e karburantit është një dokument i rëndësishëm, pasi dokumenton cilesinë e karburantit të tregtuar nga OE. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së Operatorit Ekonomik për ofrimin e karburantit cilësor.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Furnizime te ngjashme deri ne 40% te FL qe prokurohet te realizuar ne nje kontrate te vetme gjate tre viteve te fundit.
Per kete OE duhet te paraqese:Me AK, kontrate furnizimi dhe fature tatimore , ku te shenohen datat,shumat dhe sasite e mallrave. Me operator privat fature me datat dhe sasite e mallrave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 40 pika 4 dhe 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2.2. Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2021 ne te gjitha njesite e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka seline dhe ku zhvillon veprimtarine e tij ekonomike (sipas rregjistrimit ne QKR). Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te dorezoj vertetimin per

shlyerjen e taksave Vendore te parashikuara nga Pushteti Vendor per vitin 2021.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. OE duhet te jete i licensuar/autorizuar per tregtimin me shumice /pakice te mallrave te ketij lloji.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si edhe referuar Ligjit Nr. 8450 dt.24.02.1999 ”Për përpunimin, transportin dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet te ketë të paktën një stacion të shitjes se karburantit me pakice ne territorin e Bashkisë Fushe-Arrez, vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronesisie ose te jete e pasqyruar ne ekstraktin e QKB, etj).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si edhe referuar Ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 ”Për përpunimin, transportin dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet.

2.3.3. Subjekti ofertues duhet të paraqesë deklaratat si me poshte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant me pakicë me shërbim 24 orë, me tollona sipas kerkeses se Bashkise Fushe-Arrez.
- Subjekti duhet të deklarojë se tollonat kane vlere edhe per vitin 2024.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT